



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

RAPORT MONITORIMI DHE ZBATIMI

MBI

“PLANIN E INTEGRITETIT

TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT

2025 – 2027”

Periudha e monitorimit: 1 (një) vjeçare | Janar – Dhjetor 2025

Tabela e përmbajtjes:

- ↓ Përmbajtja
- ↓ Përmbledhja Ekzekutive
- ↓ Qasja vlerësuese
- ↓ Metodologjia e monitorimit

GJETJET E RAPORTIT

Objektivi 1: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me MIB/ZHR dhe institucioneve në varësi të saj.

Objektivi 2: Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga strukturat përkatëse.

Objektivi 3: Sigurimi i paanshmërisë në raportimin e rezultateve.

Objektivi 4: Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në AKU.

- ↓ Konkluzione dhe rekomandime
- ↓ Hapa të tjera

Lista e shkurtësave:

GIRECO	Grupi i Sheteve kundër Korrupsionit
MIBZHIR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
DPAKU	Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

Përmbledhje Ekzekutive:

Ndërtimi i integritetit është një aspekt i rëndësishëm për funksionimin e demokracisë dhe një domosdoshmëri për shtetin e së drejtës. Korrupsioni është një fenomen që ndikon shumë në besimin e publikut. Qëllimi i këtij plani dhe monitorimi, është vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë kapacitetet e AKU-së për të realizuar objektivat dhe shërbimin publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme në sistemin dhe fushat që institucioni mbulon.

Për të patur një administratë publike profesionale me etikë, integritet dhe të angazhuar për t'iu shërbyer qytetarëve, është i domosdoshëm forcimi i integritetit dhe miratimi i masave sistematike të anti-korrupsionit. Ky integritet, konsiston transparentë, llogaridhënie, rrajtjen e etikës, efektiviteti dhe efikasitet, përmirësimin e performancës së Administratës Publike dhe zvogëlimin e niveleve të korrupsionit.

AKU përballët me risqe integriteti të ndryshme, të cilat pengojnë realizimin e objektivave programore apo operationale të institucionit. Në këtë kuadër, procesi i menaxhimit të riskut të integritetit është një proces nëpërmjet të cilit institucioni adreson në mënyrë periodike risqet e integritetit për proceset e punës/aktivitetet (*sipas funksioneve*), me qëllimin final, forcimin e ekzistencës institucionale ndaj "*riskut të integritetit*" dhe zvogëlimin e niveleve të tij.

Mbi këtë bazë, të gjitha strukturat e organizatimit të përcaktuar në Grupin e Punës, përcaktuan objektivat specifike duke i bërë pjesë të programeve të punës së tyre, në funksion të realizimit të objektivave strategjike, si më poshtë vijon:

- Objekti i 1:** Përmirësimi i sistemit të menaxhimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me MBR/ZHR dhe institucioneve në varësi të saj.
- Objekti 2:** Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga strukturat përkatëse.
- Objekti 3:** Sigurimi i paanshmërisë në raportimin e rezultateve.
- Objekti 4:** Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në AKU.

Gjatë kësaj faze, Grupi i Punës i kushtoi vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor dhe atij të brendshëm rregullator për veprimtarinë e institucionit. Kjo fazë përfshin analizën e raporteve të ndryshme të AKU-së, përfshirë edhe raportet nga auditimet e ndryshme nga autoritetet kompetente, mbi veprimtarinë e institucionit, por edhe veprimtari të jashtme, mbi çështje që AKU operon.

Po kështu, Grupi i Punës identifikoi dhe analizoi faktorët e riskut që mund të mbështesin ose trisin risqe të tilla. Gjatë kësaj faze të procesit, u krye edhe një analizë për lushat e veprimtarisë që kërkonin vlerësim më të detajuar për shkak të ekspozimit të tyre më të madh ndaj risqeve të integritetit. Në vijim, risqet e vlerësuara dhe faktorët e tyre u renditën sipas përparësisë. Procesi vijoi me vlerësimin efektiv të masave ekzistuese të kontrollit apo kontrollleve shesë në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre.

Grupi i Punës hartoi Raportin e Monitorimit me qëllim menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, në të cilin u evidentuar: risku, kontrollat e ndërmarta, veprimet për të adresuar boshllëqet, zotëuesi i riskut dhe përfshirja e masave të reja të kontrollit apo përmirësimit e masave ekzistuese. Masat përshtatëse aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësi të organizatave për zbatimin e tyre.

Qasja Vlerësuese:

Raporti i Monitorimit është periodik (*çdo vit*) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara dhe Planin e Veprimit.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qënë efektive, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të Institucionit apo ndryshime të vet risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve (Planit të Veprimit) si dhe nxjerrjen e mësimëve për planifikimin më të mirë në të ardhmen.

Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të Integritetit për risqet e Integritetit sipas afatëve kohore të parashikuara.

Ky proces ndiqet nga personal përgjegjës të caktuar nga titullari i AKU, të cilët monitorojnë progresin e zbatimit. Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe 6 (*gjashtë*) muajore, e cila përfshin periudhën Janar-Qershor 2025 dhe Korrik-Dhjetor 2025. Raportimi i lejon titullarin për të marrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimin i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

Raporti i Monitorimit të AKU-së për zbatimin e Planit të Integritetit, referuar objektivave e aktiviteve të parashikuara për minimizimin e risqeve të integritetit dhe faktorët e risqeve, kategorinë e faktorëve të riskut, niveli të prioritetit të aktiviteve; i lartë, i moderuar ose i ulët, sipas afatëve kohore dhe me struktural përgjegjëse me aktivitetet e parashikuara, jepet sipas anekseve bashkëlidhur, si vijon:

Objektivi 1: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me MBZHIR dhe institucioneve në varësi,

Raport Monitorimi dhe Zbatimi i “Planit të Integritetit të Autoritetit Kombëtar të Usbqimit 2025-2027”

Nr.	Risku dhe faktorët e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteve; i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse	Periodha referuese	Realizimi (duke përfshirë informacionin konkret lidhur me masën e realizimit) dhe aktet e cituara (nëse ka të tilla)
1.	Mosardhja në kohë e Udhëzimeve nga Ministria e Financave dhe nga MBZHIR.	Përputhshmëri	I moderuar	Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me MBZHIR, si dhe me Drejtorinë e Planifikimit Financiar në Ministrinë e Intjës.	Drejtori i AKU, P S Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.	6-mujori i I-të dhe i II-të i 2025 <i>(periudhë 1-vjeçore)</i>	Realizuar. Aktet, udhëzimet, etj., rezultojn se kanë ardhur në kohë dhe në përputhje me afatet e përcaktuara. Po kështu, nga ana e AKU janë realizuar parashikimet në PBA 2025-2027, sipas dispozitave normuese ligjore.

2.	Mosmbërritja në kohë dhe me cilësi e informacionit mbi nevojat për fonde nga strukturat e AKU-së në Drejtorinë e Përgjithshme si dhe nevojat për fonde nga drejtoritë rajonale të institucionit.	Përpunshmëri	I moderuar	Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme dhe këshillimi i stafit të drejtorive rajonale me qëllim përmirësimin e qëllimeve të cilësive planifikimeve.	Drejtoritë përkatëse, për të cilat lind nevoja për financim.	6-mujori i I-rë dhe i II-të i 2025 <i>(përmidhë 1-vijecare)</i>	Realizuar. Kërkesat për financim janë marrë zyrtarisht nga drejtoritë dhe sektorët përkatës, duke u dorëzuar pranë Sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, si dhe Sektorit të Shërbimeve të Brendshme dhe Prokurimeve në DPAKU. Theksojmë se çdo 2 (dy) herë në vit, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale, realizohet planifikimi i kërkesave të PBA, në të cilën parashikohen nevojat tona.
3.	Mosakordimi i plotë i fondeve buxhetore të kërkuara për shpenzime operative dhe investime, si dhe miratimi me vonësë i plan-buxhetit sipas zërave, nga MBRZHR për DPAKU.	Financiar	I moderuar	Argumentimi sa më i plotë teknik dhe ligjor i nevojave për fonde.	MBRZHR e (GIMS programit të sigurisë ushqimore) për fonde në lidhje me shpenzimet e AKU-së.	6-mujori i I-rë dhe i II-të i 2025 <i>(përmidhë 1-vijecare)</i>	Në fund të çdo viti, AKU dërgon nevojat buxhetore për vitin pasardhës, në lidhje me investimet dhe shpenzimet operative. Kështu, MBRZHR miraton buxhetet sipas prioriteteve dhe planet e miratuar vijnë me vonësë. Ende ekzistojnë problematika nga ana e MBRZHR për dërgimin e këtyre planeve në kohën e duhur.

4.	Zhvillime të reja lidhur me politikat e qeverisë për inspektimin në tërësi me ndikim në kontrollet e inspektimit e sigurisë ushqimore.	Përputhshmëri	I modernuar	Rishikimi i prioriteteve në fushën e sigurisë ushqimore (në drejtim të intensifikimit të kontrolleve zyrtare dhe inspektimeve).	Struktural në DPAKU.	6-mujori i I-rë dhe i II-të i 2025 <i>(periudhë 1-vjeçare)</i>	Në kuadër të ligjit nr.99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve ligjore e nënligjore të ndryshuara si pasojë e këtij shfuqizimi, janë marrë vazhdimisht veprime për një menaxhim sa më efektiv të burimeve të brendshme financiare në dispozicion, si dhe intensifikimi i kontrolleve zyrtare (inspektimeve).
5.	Mosrealizimi në kohë i procedurave elektronike të prokurimit të fondeve buxhetore, për arsye të procedurave dhe mosparaqitjes së operatorëve ekonomike.	Operacional	I modernuar	Pjesëmarrja në trajnime e punonjësve që merren me procedurat e prokurimit, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.	Sektori i Shërbimeve të Brendshme dhe Prokurimeve në DPAKU.	I-rë dhe i II-të i 2025 <i>(periudhë 1-vjeçare)</i>	Ky objektiv lidhet kryesisht me shpenzimet operative & blegjet e vogla. Sipas monitorimit të kryer dhe verifikimit në Regjistrin e Prokurimeve për vitin 2025, rezultoi se procedurat janë kryer rregullisht.

6.	Hartimi i Termave të Referencës me cilësi të dobët.	Operacional	I modernuar	Nevoja për përmirësimin dhe unifikimin e standardeve të projektimit.	Drejtoritë e AKU.	6-mujori i I-rë dhe i II-të i 2025 <i>(përfundohet viteve)</i>	Pas mbikëqyrjes së vazhdueshme, janë konsideruar nga drejtoritë përmirësimet sipas rasteve, të termave të referencës në bazë të eksperiencës.
7.	Vonesat e procedurave të prokurimit.	Operacional	I lartë	Ndjekja e afateve të procedimit sipas legjislationit në fuqi.	Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme në DP/AKU.	6-mujori i I-rë dhe i II-të i 2025 <i>(përfundohet viteve)</i>	Procedurat e prokurimit kanë vonesa përkatëse, të cilat lidhen ngushtë me procedurat e vendimmartjes nga ana e KPP, në varësi të ankesave të operatorëve ekonomikë. Përpos kësaj problematike, nuk rezultojn të ketë patur vonesa në lidhje me zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

Objekti 2: Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga strukturat përkatëse.

Raport Monitorimi dhe Zbatimi i “Planit të Integritetit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit 2025-2027”

Nr.	Risku dhe faktorët e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse	Perioda referuese	Realizimi (duke përfshirë informacionin konkret lidhur me masën e realizimit) dhe aktet e cituara (nëse ka të tilla)
1.	Sigurimi i bashkëpunimit me drejtoritë teknike, lidhur me kuptueshmërinë dhe zbatimin e aktiveve ligjore e nënligjore.	Përpulshmëri	I lartë	Bashkëpunimi me MBZ/HR është i rëndësishëm së lartë sidomos në rastet kur aktet ligjore dhe nënligjore kanë kompleksitet.	Drejtoritë teknike të MBZ/HR-së dhe Drejtoritë teknike të AKU-së.	6-mujori i 1-të dhe i II-të i 2025 (periudhë 1-vjeçore)	Konkludohet se ka bashkëpunim të vazhdueshëm institucional. Në vijim të zbatimit të masës së parashikuar në kohën e paraqitjes së një detyre të përbashkët, kryhen takime me specialistët e fushës konkrete, zhvillohen diskutime, kërkohet mendimi ligjor i një/disa ekspertëve të fushës përkatëse, etj.

Objekti 3: Sigurimi i paanshmërisë në raportimin e rezultateve.

Raport Monitorimi dhe Zbatimi i “Planit të Integritetit të Autoritëit Kombëtar të Ushqimit 2025-2027”

Nr.	Risku dhe faktorët e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse	Perioda referuese	Realizimi (duke përfshirë informacionin konkret lidhur me masën e realizimit) dhe aktet e cituara (nëse ka të tillat)
1.	Shtatëgjatësia e subjektivizimit të inspektorëve gjatë kontrolleve zyrtare, në kuadër të licencimeve të Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU).	Operacional	I mesëm	Përmirësimi dhe vendosja e kriterëve objektive e të matshme në listë-verifikimit e procedurave të licencimit.	Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Kontrollit Zyrtar në DPAKU si dhe drejtoritë rajonale të AKU.	6-mujori i I-të dhe i II-të i 2025 (periudhë 1-vjeçare)	Realizuar. Në kuadër të këtij objekti janë miratuar rregullisht listë-verifikimet sipas kriterëve ligjorë të licencimit, kategorive të tyre dhe kërkesave specifike për procedurën e licencimit.

Objekti 4: Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në AKU.

Raport Monitorimi dhe Zbatimi i “Planit të Integritetit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit 2025-2027”

Nr.	Risku dhe faktorët e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse	Periodha referuese	Realizimi (duke përfshirë informacionin konkret lidhur me masën e realizimit) dhe aktet e cituara (nëse ka të tilla)
1.	Mosrealizimi në kohë dhe/ose në mënyrën e duhur të proceseve të punës, për shkak të personelit të panjaftueshëm për një kohë të konsiderueshme.	Operacional	I mesëm	Plotësimi i numrit të burimeve njerëzore (stafit) me qëllim realizimin e detyrave në kohë dhe në përputhje me kërkesat ligjore.	Drejtoritë Përkatese të AKU.	6-mujori i I-të dhe i II-të i 2025 (periudhë 1-vjeçare)	Realizuar në përqindjen më të madhe të punës, për vetë natyrën teknike dhe urgjente që AKU ka në lidhje me menaxhimin e stafit, rekrutimin, administrimin e marrëdhënieve të punës dhe trajtimin e kërkesave ligjore. Përmes planifikimit të mirëorganizuar, ndjekjes së afërta dhe plotësimit e angazhimit të stafit të sektorëve përkatës, është arritur realizimi në kohë i proceseve kyçe.

					Struktura e AKU-së përcaktohet me Urdhër të Kryeministrit Nr.7, datë 10.01.2025. Sipas përcaktimeve të kësaj strukture, nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokolli janë ndjekur rregullisht procedurat e rekrutimit si dhe janë plotësuar kryesisht mungesat (vendet vakante) në drejtim të sektoreve të shërbimeve të brendshme, duke mundësuar funksionimin në mënyrë optimale të sektoreve, menaxhimin e rregullt dhe efikas të proceseve të punës, përmirësimin në organizimin e detyrave dhe përmirësimin e tyre brenda afateve ligjore. Në lidhje me rakordinin ndërmjet drejtorive rajonale dhe DPAKU, ky Sektor i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokolli ka mbajtur kontakte të rregullta e të vazhdueshme me qëllim mirëorganizimin dhe mbarevajtjen e punës.	
2.	Personeli i punëftueshëm, kryesisht në sektorë me ngarkesa të vazhdueshme.	Operacional	1 mesëm	Ndjekja e procedurave të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokolli në DPAKU.	Sektor i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokolli, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme në DPAKU.	6-mujori i I-të dhe i II-të i 2025 <i>(përvindhë 1-vjeçare)</i>

3. Kuadri i brendshëm rregullator për dorëzimin e detyrës nga punonjësit e larguar nga puna.	Operacional	I lartë	Përfshirja e rregullave të hollësishme në Rregulloren e Brendshme të AKU-së dhe zbatimin i tyre me rigorozitet.	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokolli, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme në DPAKU.	6-mujori i I-rë dhe i II-të i 2025 (përfundim i vërejtjeve)	Realizuar. Në përputhje me dispozitat normative të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar), si dhe në parashikimet e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të institucionit “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, miratuar me Urdhër nr.297, datë 23.06.2022 të MBZ/HR, në rastet e largimit të punonjësve të AKU nga puna, qoftë këto raste të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës, apo ato zgjidhje sipas afateve ligjore, ndërprerjet për shkak dorëheqje, për shkak të plotësimit të moshës për dalje në pension, etj., Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokolli ka ndjekur me përpikmëri procedurat e dorëzimit të detyrës, materialeve dhe inventareve të ngarkuara tek punonjësi, duke e dokumentuar rregullisht këtë proces.
---	--------------------	----------------	--	---	--	---